

# STRATEGJIA AFATMESME E ZHVILLIMIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR PERIUDHËN 2019-2021

Strategjia afatmesme e zhvillimit të Bankës së Shqipërisë  
për periudhën 2019-2021, u miratua nga  
Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr. 72,  
datë 26.12.2018.

Këtë publikim mund ta gjeni edhe në formë elektronike në adresën:

[www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org)

Botuar nga: Banka e Shqipërisë,  
Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë  
Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419401/2/3  
Faks: + 355 4 2419408

ose duke dërguar një e-mail në adresën:

[public@bankofalbania.org](mailto:public@bankofalbania.org)

# P Ë R M B A J T J A

1.	MISIONI	5
2.	VIZIONI	6
3.	VLERAT	7
4.	<b>OBJEKTIVAT AFATMEËM</b>	<b>8</b>
4.1	<i>Politika monetare</i>	8
4.2	<i>Nxjerrja dhe qarkullimi i monedhës shqiptare</i>	16
4.3	<i>Nxitja e funksionimit normal të sistemit të pagesave</i>	18
4.4	<i>Promovimi i stabilitetit të sistemit financiar</i>	19
4.5	<i>Mirëqeverisja e institucionit</i>	25
4.6	<i>Sistemi i kontrollit të brendshëm</i>	29
4.7	<i>Kapitali njerëzor, fizik dhe financiar</i>	32

zhvillim  
për periudhën  
zhvillimit për periudhën 201  
zhvillimit për periudhë  
ZHVILLIMIT PËR PERIUDH  
MIT PËR PERIUDHËN 2019-2021 M

STRATEGJIA AFATMESME E ZHVILLIMIT PËR PERIUDHËN 2019-2021  
periudhën 2019-2021 VLERAT

19-2021 MISSIONI Strategjia afatme  
n 2019-2021 MISSIONI

periudhën 2019-2021  
ZHVILLIMIT PËR P

AFATMESME E ZHV

e zhvillimit për  
afatmesme

gjia afatme  
2019-20

AFATMESME

mesme  
SD

mit r  
ME F

ME F

it p  
St

zh  
20

20

20

ME F

1

1

# 1. MISIONI

Si banka qendrore e shtetit, Banka e Shqipërisë ka të drejtën ekskluzive: (i) të hartimit dhe zbatimit të pavarur të politikës monetare - objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve që është kontributi më i mirë që mund të japë politika monetare për rritjen e qëndrueshme dhe afatgjatë ekonomike të vendit; (ii) të nxjerrjes e të qarkullimit të monedhës shqiptare, duke siguruar ruajtjen e besimit publik të paraja, përmes garantimit të cilësisë së kartëmonedhave dhe monedhave dhe plotësimit të sigurt dhe eficient të nevojave të ekonomisë për para; (iii) të mbajtjes e të administrimit të rezervave valutore të Republikës së Shqipërisë, si garanci për përballimin e goditjeve të rënda në sektorin real të ekonomisë, dhe në mbështetje të qëndrueshmërisë financiare të vendit.

Si emetuese e monedhës kombëtare, Banka e Shqipërisë nxit funksionimin normal të sistemit të pagesave, me synim: sigurimin e qarkullimit të sigurt, të shpejtë dhe me kosto të ulët të parasë në ekonomi; parandalimin e rrezikut sistemik; dhe ruajtjen e stabilitetit të institucioneve dhe tregjeve financiare.

Banka e Shqipërisë promovon stabilitetin e sistemit financiar – besimin publik tek institucionet, tregjet dhe infrastruktura financiare – duke rregulluar, licencuar dhe mbikëqyrur bankat dhe institucionet e tjera financiare, si dhe duke identifikuar dhe analizuar rregullisht rreziqet dhe kërcënimet ndaj stabilitetit financiar.

## 2. VIZIONI

Përmirësimi i mirëqeverisjes së Bankës së Shqipërisë, me qëllim rritjen e besimit të publikut tek institucioni. Kjo do të realizohet përmes rritjes së:

- a) pavarësisë në përmbushjen e misionit dhe objektivave ligjorë, në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga procesi i përafrimit gradual të legjislacionit dhe politikave tona me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe Sistemit Evropian të Bankave Qendrore;
- b) llogaridhënies publike për përmbushjen e detyrave kryesore, objektivit kryesor dhe objektivave të tjerë ligjorë të Bankës së Shqipërisë. Kjo përfshin edhe adoptimin e standardeve më të mira të kontabilitetit dhe auditimit, publikimin e raporteve të rregullta financiare, si dhe sigurimin e integritetit të proceseve të auditimit të jashtëm dhe të brendshëm, si elemente kyçe të llogaridhënies publike;
- c) transparencës mbi veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë, përmes një komunikimi të hapur dhe të qartë me publikun. Banka e Shqipërisë do të marrë masat e duhura, në përputhje me ligjin dhe politikën e saj, për të rritur kuptueshmërinë dhe parashikueshmërinë e politikës monetare, përmirësuar llogaridhënien dhe forcuar besueshmërinë publike të institucionit.

### 3. VLERAT

Në funksion të forcimit të besimit publik tek institucioni, veprimtaria e Bankës së Shqipërisë udhëhiqet nga vlerat më poshtë.

- a) Integriteti dhe etika: të vepruarit në përputhje me normat ligjore dhe morale, si dhe me standardet më të larta të etikës, duke shmangur çdo ndikim të papërshtatshëm nga ana e personave apo organizatave jashtë institucionit, në përmbushjen e detyrave ligjore.
- b) Kompetenca dhe profesionalizmi: të vepruarit me ekspertizën, njohuritë, aftësitë, kualifikimet dhe cilësitë e nevojshme.
- c) Efektiviteti dhe efikasiteti: të vepruarit në mënyrë që rezultatet e dëshiruara të arrihen sa më mirë, duke përdorur burime minimale.
- d) Puna në grup dhe inovacioni: të vepruarit në mënyrë bashkëpunuese, falë ndihmës reciproke dhe ndarjes së njohurive, si dhe me iniciativë dhe kreativitet në prezantimin e ideve të reja.

## 4. OBJEKTIVAT AFATMESËM

Prioritetet në veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë përcaktohen në ligjin organik. Objektivi kryesor është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Në përputhje me këtë objektiv, Banka e Shqipërisë nxit dhe mbështet:

- a) sistemin e këmbimeve valutore;
- b) tregun e brendshëm financiar;
- c) sistemin e pagesave; si dhe
- d) ndihmon në përmirësimin e kushteve monetare e kredituese, në mbështetje të stabilitetit dhe të zhvillimeve ekonomike të vendit.

Objektivat e tjerë kushtëzohen nga objektivi kryesor dhe nxisin ruajtjen e likuiditetit, aftësinë paguese dhe funksionimin normal të sistemit bankar, bazuar në parimet e tregut.

### 4.1 POLITIKA MONETARE

Banka e Shqipërisë harton dhe zbaton politikën monetare, në mbështetje të rritjes së qëndrueshme dhe afatgjatë të ekonomisë, rritjes së mirëqenies së shqiptarëve dhe ruajtjes së stabilitetit financiar të vendit.

Politika monetare bazohet në regjimin e shënjestrimit të inflacionit dhe parashikon zbatimin e regjimit të lirë të kursit të këmbimit.

Për periudhën 2019-2021, synohet rritja e efektivitetit, fleksibilitetit dhe transparencës së politikës monetare. Strategjia e zhvillimit të politikës monetare bazohet në trendet e zhvillimeve të brendshme e të jashtme, identifikimin e sfidave të së ardhmes, dhe në shfrytëzimin e praktikave më të mira botërore të fushës. Kjo strategji rishqyrtohet në intervale kohore të rregullta.



## Objektivat, masat dhe rezultatet e pritura

- a) Zhvillimi i kuadrit analizues dhe parashikues, duke synuar përmirësimin e mëtejshëm cilësor të procesit të hartimit e zbatimit të politikës monetare;

Arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve kërkon një kuadër solid e të besueshëm të politikës monetare, si dhe informacionin dhe modelet më të mira në dispozicion. Banka e Shqipërisë synon përmirësimin dhe përditësimin e modeleve të parashikimit dhe analizës së politikës monetare, aplikimin e teknikave bashkëkohore në fushën e modelimit, si dhe përditësimin e njohurive të personelit me të rejtat më të fundit.

Përmbushja e këtij objektivi mundëson:

- gjenerimin e parashikimeve makroekonomike të mbështetura në një platformë solide e të avancuar;
- analiza të thelluara të lidhjeve makroekonomike dhe të funksionimit të ekonomisë shqiptare;
- vlerësimin e përcjelljes së politikës monetare në ekonomi dhe matjen e efekteve të saj; si dhe lehtëson, ndërlidhjen midis politikës monetare dhe asaj makroprudenciale.

Banka e Shqipërisë synon implementimin e praktikave më të mira ndërkombëtare në kërkimin shkencor, vlerësimin empirik të funksionimit të ekonomisë dhe të tregjeve financiare shqiptare, si dhe trajnimin e vazhduar të personelit.

- b) Mirëmbajtja dhe zhvillimi i kuadrit të instrumenteve të politikës monetare, duke synuar rritjen e efektivitetit dhe fleksibilitetit të saj;

Funksionimi i mekanizmit të transmetimit të politikës monetare dhe vlerësimi i eficiencës së instrumenteve përbëjnë një tjetër prioritet të përhershëm. Studimi i kanaleve të mekanizmit të transmetimit dhe vlerësimi i efektivitetit të gamës së instrumenteve, mundëson adresimin e sfidave të reja me qasjet e duhura, duke ndihmuar përmbushjen e objektivave të politikës monetare.

Transmetimi i politikës monetare është i lidhur ngushtë me zhvillimin e tregjeve financiare. Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të bashkëpunojë ngushtë me institucionet përkatëse për zhvillimin e mëtejshëm të tyre. Për këtë qëllim, do të studiohen, në vazhdimësi, efektet e instrumenteve të politikës monetare, duke synuar zhvillimin dhe rritjen e mëtejshme të efektivitetit të tyre.

- c) Përmirësimi i mëtejshëm i komunikimit me publikun për të rritur kuptueshmërinë, parashikueshmërinë dhe efektivitetin e politikës monetare;

Banka e Shqipërisë synon të komunikojë qartë dhe në mënyrë efektive vendimmarrjen e politikës monetare, duke: ndihmuar familjet e bizneset të jenë të mirinformuar në vendimmarrje; reduktuar pasiguritë ekonomike e financiare; rritur efektivitetin dhe llogaridhënien e politikës monetare.

Për këtë qëllim, synohet shtimi i gamës dhe cilësisë së publikimeve, duke rritur njëkohësisht qartësinë e komunikimit.

- d) Zhvillimi i mëtejshëm i komunikimit dhe bashkëpunimit me partnerët e brendshëm dhe të huaj, në interes të rritjes së sinergjisë së politikave të brendshme ekonomike dhe të mbështetjes së procesit të integritimit evropian.

Rritja e efektivitetit të politikës monetare kërkon, ndër të tjera, rritjen e bashkërendimit me politikën fiskale, njohjen dhe konsultimin me reformat e gjithanshme strukturore, si dhe dialogun me partnerët e ndryshëm vendas. Objektivi kombëtar i integritimit evropian kërkon një dialog të vazhdueshëm me partnerët evropianë, si dhe njohjen e implementimin e legjislacionit evropian në fushën e Bashkimit Ekonomik dhe Monetar.

#### **4.1.1. POLITIKA E KURSIT TË KËMBIMIT DHE ADMINISTRIMI I REZERVËS VALUTORE**

Banka e Shqipërisë miraton e zbaton politikën e kursit të këmbimit dhe administron rezervën valutore të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare. Administrimi i rezervës synon të sigurojë:

- plotësimin e nevojave për likuiditet në monedhë të huaj, të lidhura me zbatimin e politikës monetare dhe asaj të kursit të këmbimit, dhe mbulimin e nevojave të vendit në periudha krize;
- mbajtjen nën kontroll, në mënyrë sa më të kujdeshme, të rrezikut të likuiditetit, të tregut dhe të kreditit, gjatë investimit të rezervës në institucionet financiare; dhe
- gjenerimin e të ardhurave të arsyeshme, në një periudhë afatgjatë, nga fondet e investuara, për sa kohë që kjo nuk bie ndesh me kriteret e likuiditetit dhe sigurisë të përcaktuara më sipër.

Banka e Shqipërisë do të zhvillojë kapacitetet profesionale për vënien në zbatim të fleksibilitetit të shtuar të instrumenteve të politikës monetare dhe mekanizmave të ndjekjes së tregut të brendshëm të këmbimeve valutore.

#### **Objektivat, masat dhe rezultatet e pritura**

- a) Ndjekja, analizimi dhe nxitja e zhvillimeve në tregjet e brendshme financiare. Banka e Shqipërisë do të mbështesë Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë,

si institucioni emetues i titujve të shtetit shqiptar, me njohuri, operacione dhe analiza, në realizimin e projektit pilot për emetimin e titujve referencë nëpërmjet zhvilluesve të tregut. Gjithashtu, mbështetje me ekspertizë do t'i ofrohet Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për rishikimin e ligjit për titujt.

Burimet e nevojshme për realizimin e këtij objekti

- Teknologji. Zhvillim të sistemit qendror të shlyerjes dhe regjistrimit të titujve shtetërorë (AfiSaR), si dhe shtesë kontrate në sistemin e informacionit REUTERS për të akomoduar operacionet e reja, në kuadër të emetimit të titujve referencë nëpërmjet zhvilluesve të tregut;
- Burime njerëzore. Shtesë në strukturë, në rast të zgjerimit të projektit pilot në më shumë se një titull referencë, si dhe trajnime të personelit;
- Burime financiare. Zhvillimet në burimet teknologjike dhe njerëzore do të shoqërohen me kosto financiare.

Vlerësimi për arritjen e objektivit do të bëhet nëpërmjet realizimit të:

- rritjes së tregtimit/likuiditetit në tregun sekondar të titujve shtetërorë;
  - përmirësimit të konkurrencës, raportit kërkesës/ofertë etj. në tregun primar të emetimit të titujve të shtetit shqiptar.
- b) Përmirësimi i rezultatit financiar të investimit të rezervës valutore dhe diversifikimit.

Kjo do të kryhet nëpërmjet shtimit të klasave të instrumenteve me:

- *Covered bonds*;
- Kontratat e të ardhmes;
- *Reverse REPO*;
- *MBS (mortgage backed security)*;
- *ILB (inflation linked bonds)*.

### **Masat, teknologjitë dhe burimet njerëzore e financiare të nevojshme për arritjen e këtyre objektivave**

- Vijimi i trajnimit të personelit dhe shkëmbimi i përvojës me institucionet homologe dhe banka tregtare partnere.
- Rritja e kapaciteteve të sistemeve aktuale ose blerja e një sistemi të ri për të mbështetur zgjerimin e klasave të instrumenteve ku investohet.
- Ndryshimet rregullative dhe nevoja e këshillimit ligjor të jashtëm për marrëveshjen model *Global Master Repurchase Agreement* me institucionet e ndryshme bankare për instrumentet REPO.

## Vlerësimi i përmbushjes së objektivave

- Arritja e objektivave të mësipërm mundëson rritjen e kthimit të portofolit në total me rreth 10-15 pikë bazë në vit dhe me një volatilitet të ngjashëm me atë aktual. *Covered bonds* dhe *MBS* janë asete me volatilitet historik më të lartë se klasat e asetëve që blihen aktualisht. Megjithatë, synohet që kombinimi i tyre me asetet tradicionale, ILB dhe kontratat e së ardhmes – të cilat rrisin fleksibilitetin e administrimit aktiv – do të sjellë, në afatin e mesëm, një volatilitet të paktën të njëjtë me atë historik të portofolit.
- Mënyra e matjes do të ishte: (i) për kthimin absolut, duke krahasuar kthimin që do të rezultonte për *benchmark*-un pa përfshirë klasat e reja, me kthimin e *benchmark*-ut me klasat e reja; dhe (ii) për kthimin relativ, si rezultat i administrimit aktiv me dhe pa klasat e reja.

### 4.1.2. STATISTIKAT

Banka e Shqipërisë synon të paraqesë në publik statistika të plota që përputhen me standardet ndërkombëtare dhe shërbejnë si bazë për zbatimin e politikës monetare, politikës makro dhe mikroprudenciale.

Statistikat zyrtare të prodhuara nga Banka e Shqipërisë përdoren nga institucionet shtetërore, pjesëmarrësit e tregut financiar, mediat, organet ndërkombëtare dhe publiku i gjerë. Ofrimi i statistikave dhe analizave cilësore do vazhdojë të jetë parësor në informimin për qëllime politikëbërëse, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, dhe në shpjegimin e zhvillimeve të tregjeve financiare.

Objektivat në fushën e statistikave lidhen me plotësimin e standardeve sasiore të metodologjive ndërkombëtare dhe legjislacionit të Bashkimit Evropian, lidhur me përmbajtjen dhe raportimin e statistikave pranë organizmave evropiane dhe ndërkombëtarë.

Vëmendje të veçantë do t'i kushtohet ndërtimit të databazave me të dhëna të grimcuara për të rritur konsistencën mikro-makro dhe për të lejuar ndërtimin e treguesve të rinj. Gjithashtu, do të punohet për përmbushjen e kriterëve të cilësisë së statistikave, sipas kërkesave të kodeve të praktikave dhe standardeve ndërkombëtare të cilësisë së të dhënave. Nxitja dhe thellimi i dialogut me përdoruesit e të dhënave për të identifikuar më mirë nevojat e tyre, do të mbetet në fokus të punës.

### Objektivat kryesorë për periudhën

- a) Zhvillimi dhe implementimi i standardeve dhe kërkesave ndërkombëtare;

- i. Banka e Shqipërisë do të punojë për implementimin e rregullores nr. 2016/867 të Bankës Qendrore Evropiane për mbledhjen e të dhënave të detajuara, lidhur me kredinë dhe rrezikun e kredisë, në funksion të implementimit të kërkesave të reja raportuese nga sistemi bankar, në kuadër të Regjistrimit të Kredive dhe ndërtimit të një databaze me informacion të detajuar për kreditë dhënë personave fizikë dhe juridikë.

Brenda 2019, do të përditësohet Regjistri i Kredive, duke mundësuar standardizimin e informacionit të grumbulluar për qëllime mbikëqyrëse, statistikore, për politikën makroprudenciale për operacionet e politikës monetare dhe kërkimit në Bankën e Shqipërisë.

- ii. Implementimi i kërkesave të reja për statistikat e titujve

Në fokus është implementimi (brenda vitit 2020) i rregullores nr. 2015/730 të Bankës Qendrore Evropiane lidhur me statistikat e titujve, si dhe ndërtimi i një databaze të gjerë, me informacion të detajuar, në lidhje me titujt e mbajtur nga institucionet kredituese dhe filialet e tyre në vend.

Kjo do të mundësojë të dhëna më të detajuara dhe cilësore për titujt, duke siguruar analiza më të plota në fushat e tregut të operacioneve, politikës monetare dhe stabilitetit financiar.

- iii. Konsolidimi i burimeve të informacionit dhe metodikës së vlerësimit në hartimin e Llogarive Financiare, për të gjithë sektorët ekonomikë, në përputhje me kërkesat e Bankës Qendrore Evropiane dhe Eurostatit

Banka e Shqipërisë do të zhvillojë metodologji për vlerësimin e borxhit të korporatave jofinanciare e të individëve dhe do të publikojë llogari financiare të harmonizuara, me bazë tremujore, për të gjithë sektorët ekonomikë. Kjo do të plotësojë kuadrin analitik për vendimmarrjen e politikës monetare dhe stabilitetit financiar, brenda vitit 2020.

- iv. Plotësimi i kuadrit të treguesve të shëndetit financiar

Gjatë periudhës afatmesme do të zhvillohen metoda vlerësimi për hartimin e treguesve shtesë, me rëndësi për vlerësimin e shëndetit të sektorit bankar dhe bankave në veçanti, të lidhur me veprimtarinë e institucioneve të tjera financiare, korporatave jofinanciare, individëve dhe tregjeve të pasurive të paluajtshme.

Kjo i shërben plotësimit, brenda vitit 2020, të kuadrit analitik, në mbështetje të analizave vlerësuese dhe politikave makroprudenciale.

- v. Përafrimi i rregullores nr. 1071/2013 të Bankës Qendrore Evropiane, lidhur me bilancin e institucioneve monetare dhe financiare

Gjatë vitit 2020, do të hartohet rregullorja, sistemi raportues dhe udhëzuesit përkatës që mundësojnë harmonizimin me standardet e Bashkimit Evropian në fushën e hartimit të agregatëve monetarë, duke siguruar përputhshmëri me kërkesat për raportim të Bankës Qendrore Evropiane.

- b) Përmirësimi i infrastrukturës në mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen e informacionit statistikor;

Ky objektiv do të realizohet përmes:

- përmirësimin të infrastrukturës teknologjike falë automatizimit të procesit të prodhimit të statistikave, brenda vitit 2020;
- investimit të mëtejshëm në Sistemin Elektronik Raportues Rregullator në drejtim të krijimit të një platforme dinamike, databaze shumëdimensionale (*Data Warehouse* dhe *Business Intelligence Tools*), brenda vitit 2019;
- rritjes së bashkëpunimit me agjencitë e tjera statistikore, përmes memorandumeve të mirëkuptimit dhe aktiviteteve të përbashkëta.

- c) Shtimi i treguesve të rinj statistikorë.

Ky objektiv do të realizohet përmes:

- plotësimin të detyrimeve që rrjedhin nga "Plani i Veprimit për Statistikat Ekonomike, Monetare dhe Financiare për vendet kandidatë dhe kandidatët potencialë në Bashkimin Evropian":
  - o raportimi i tregtisë ndërkombëtare në shërbime dhe statistikave të bilancit të pagesave sipas ndarjes gjeografike, e cila do të mundësojë zgjerimin e bazës së treguesve statistikorë, rritjen e nivelit të detajimit dhe të shkallës së mbulimit të treguesve (brenda vitit 2021),
  - o hartimi, publikimi dhe raportimi i statistikave të bilancit të pagesave me periodicitet mujor (brenda vitit 2020),
  - o hartimi, publikimi dhe raportimi i statistikave të kompanive me origjinë shqiptare jashtë vendit (OFATS, në bashkëpunim me INSTAT); si dhe
- hartimit dhe publikimit të statistikave të normave të interesit, sipas kërkesave të Bankës Qendrore Evropiane, brenda vitit 2019.

#### 4.1.3. KËRKIMI SHKENCOR

Banka e Shqipërisë synon të përgatisë studime cilësore ekonomike në fushat e saj të interesit, duke kontribuar në njohjen e ekonomisë shqiptare dhe të proceseve

ekonomike, shoqërore dhe politike, që e ndikojnë atë. Kërkimi shkencor i aplikuar në fushën e ekonomisë dhe financës hulumton hipotezat e ngritura nga analizat ekonomike dhe të kërkimit shkencor.

### Objektivat kryesorë për periudhën

Objektivi kryesor është integrimi i rezultateve të studimeve ekonomike dhe analizave empirike për të këshilluar dhe ndihmuar vendimmarrjen, në përmbushje të objektivave të politikës monetare, stabilitetit të financiar dhe rregullimit të tregut financiar. Inovacioni, kompetenca dhe profesionalizmi janë vlerat që kërkohet të përcillen në fushën e kërkimeve, mbështetur në ndërveprimin dhe kreativitetin e çdo njësie organizative.

Banka e Shqipërisë do të zhvillojë e testojë teknika statistikore për strukturimin dhe shfrytëzimin e informacionit statistikor të gjeneruar nga zhvillimet në fushën e teknologjisë së informacionit dhe përhapja e tyre në çdo aspekt të jetës ekonomike e shoqërore. Për këtë qëllim, synohet adoptimi dhe përdorimi i metodologjive të kërkimit të bazuara në platformën "*Big Data*", në funksion të analizave dhe parashikimeve për zhvillimet ekonomike.

"*Big data*" është një standard i ri i bankave qendrore që mundëson perceptimin e bazave të të dhënave, metodologjive dhe *software*-ve të nevojshëm për analizimin dhe interpretimin e informacionit statistikor. Përdorimi sistematik i kësaj platforme do të jetë pjesë e analizave dhe parashikimeve të Bankës së Shqipërisë në funksion të vendimmarrjes, për të garantuar stabilitetin monetar dhe financiar.

Në kuadër të plotësimit të informacionit statistikor me natyrë mikroekonomike dhe studimit të sjelljes së konsumatorëve në Shqipëri, do të zgjerohet baza e të dhënave statistikore mbi familjet shqiptare dhe karakteristikat e tyre ekonomike e financiare. Ky objektivi do të realizohet nëpërmjet anketimeve statistikore. Qëllimi parësor është:

- të prezantojë një bashkësi të re informacioni statistikor mbi familjet;
- të përmirësojë dhe të thellojë punën kërkimore, në funksion dhe zbatim të objektivave të politikës monetare dhe stabilitetit financiar;
- të unifikojë burimet e informacionit, në përputhje me standardet më të mira evropiane dhe ndërkombëtare.

Banka e Shqipërisë synon të nxisë diskutimin dhe analizën e kërkimit shkencor, duke u përqendruar në drejtimet e mëposhtme:

- riorganizimin dhe rritjen e nivelit, formës dhe përmbajtjes akademike të aktiviteteve kërkimore, si Seminari i të Premtes dhe Workshop-i i Kërkimeve;
- publikimin e kërkimit dhe punës shkencore në revista ndërkombëtare me reputacion në fushën e ekonomisë dhe të financës;

- ngritjen e kapaciteteve kërkimore shkencore, përmes bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë dhe pjesëmarrjes në seminare e konferenca ndërkombëtare, për të rritur ndërveprimin me personelin akademik, brenda dhe jashtë vendit, mbi tema në interesin e institucionit.

## 4.2 NXJERRJA DHE QARKULLIMI I MONEDHËS SHQIPTARE

Banka e Shqipërisë synon ruajtjen e besimit publik të para, përmes garantimit të cilësisë së kartëmonedhave e monedhave dhe plotësimin të sigurt dhe eficient të nevojave të ekonomisë për para.

### Objektivat kryesorë gjatë periudhës

- a) Plotësimi i nevojave të ekonomisë për para të gatshme dhe të përshtatshme për qarkullim;

Studimi në vijimësi i nevojave në rritje të ekonomisë për para të gatshme dhe të përshtatshme për qarkullim është fokusi kryesor në periudhën afatmesme në vijim. Kjo do të arrihet përmes:

- ndjekjes me baza mujore të gjendjes së sasisë së parasë së gatshme (fonde logjistike dhe strategjike), krahasuar me kërkesën e ekonomisë për para, në situata normale dhe të jashtëzakonshme;
  - prodhimin të kartëmonedhave me dizajn të përmirësuar dhe hedhjes së tyre në qarkullim brenda afateve të mëposhtme:
    - o kartëmonedhat 200 dhe 5000 Lekë brenda vitit 2019,
    - o kartëmonedha 1000 Lekë brenda vitit 2020,
    - o kartëmonedhat 2000 dhe 500 Lekë brenda vitit 2021;
  - prodhimin dhe hedhjes në qarkullim të prerjes së re 10,000 Lekë brenda vitit 2020.
- b) Përmirësimi i cilësisë së kartëmonedhave në qarkullim, nëpërmjet rritjes së efektivitetit dhe kapacitetit në veprimtarinë përpunuese;

Garantimi i cilësisë së kartëmonedhave synon, në radhë të parë, ruajtjen e integritetit të kartëmonedhës, në raport me publikun përdorues, dhe ruajtjen e një imazhi dinjitoz të Bankës së Shqipërisë dhe të vetë shtetit shqiptar. Kjo do të realizohet përmes:

- zhvillimit të mëtejshëm të proceseve të automatizuara dhe bashkëkohore të përpunimit, paketimit dhe shkatërrimit të kartëmonedhave, në qendrën e *cash-it*;



- zëvendësimin të sistemeve të përpunimit me sisteme më të avancuara në degët e Bankës Shqiptarisë;
- kontrollin të përhershëm dhe nxitjes së sistemit bankar në përdorimin e sistemeve të certifikuara dhe autorizuara nga Banka e Shqipërisë për pranimin dhe përpunimin e kartëmonedhave.

c) Mbrojtja nga falsifikimi;

Mbrojtja nga falsifikimi synon ruajtjen dhe rritjen e besimit të publikut të monedha kombëtare. Ky objektiv sigurohet nëpërmjet:

- përmirësimin të vazhdueshëm të elementeve të sigurisë së kartëmonedhës shqiptare;
- përmirësimin të vazhdueshëm të kapaciteteve dhe aftësive njerëzore të personelit, nëpërmjet trajnimeve, kualifikimeve dhe pjesëmarrjes në seminare dhe *workshope*, në fushën e parandalimit dhe mbrojtjes së monedhave nga falsifikimi;
- rritjes së bashkëpunimit në fushën e falsifikimit, duke formalizuar marrëveshje me autoritetet kombëtare dhe evropiane për këtë qëllim;
- organizimit të seminareve me punonjës të sistemit financiar, për t'i informuar, orientuar dhe trajnuar ata, lidhur me elementet e sigurisë të kartëmonedhave shqiptare, si dhe të faktorëve që sjellin minimizimin e falsifikimit të tyre.

d) Përmirësimi i administrimit dhe forcimi i sigurisë fizike të vlerave monetare.

Banka e Shqipërisë do të forcojë praktikën e kontrollit dhe masat e mbrojtjes fizike që garantojnë sigurinë dhe pacenueshmërinë e vlerave monetare që administrojnë, në funksion të emisionit të thesarit dhe në përputhje me praktikën më të mirë të fushës. Kjo do të realizohet përmes:

- rishikimit, sa herë që është e nevojshme, të rregullave dhe procedurave të administrimit të vlerave, me qëllim përsosjen e tyre dhe sigurimin e standardeve më të larta;
- përmirësimin e kushteve dhe mjediseve të depozitimit dhe ruajtjes së vlerave.

### 4.3 NXITJA E FUNKSIONIMIT NORMAL TË SISTEMIT TË PAGESAVE

Përmes funksionimit normal të sistemit të pagesave, Banka e Shqipërisë synon sigurimin e qarkullimit të sigurt, të shpejtë dhe me kosto të ulët, të parasë në ekonomi, parandalimin e rrezikut sistematik dhe ruajtjen e stabilitetit të institucioneve e tregjeve financiare.

#### Objektivat kryesorë gjatë periudhës

- a) Nxitja dhe mbikëqyrja e funksionimit normal të sistemit të pagesave; rregullimi i instrumenteve të pagesave dhe i shërbimeve mbi transfertat elektronike;

Brenda vitit 2019, Banka e Shqipërisë do të rregullojë veprimtarinë e operimit të infrastrukturave të klerimit dhe të shlyerjes së titujve, si dhe do të zgjerojë kapacitetet institucionale për licencimin dhe mbikëqyrjen e tyre.

Gjithashtu, do të punohet në drejtim të konsolidimit të mjedisit rregullator lehtësues për pagesat me vlerë të vogël. Brenda vitit 2020, do të adoptohet Direktiva e Bashkimit Evropian mbi llogaritë e pagesave. Kjo synon t'i ofrojë çdo personi të drejtën për një llogari bazike pagese, pavarësisht vendbanimit apo gjendjes së tij financiare, të përmirësojë transparencën e tarifave të këtyre llogarive, si dhe të lehtësojë kalimin nga një bankë te tjetra.

Zgjerimi i përqindjes së popullsisë që zotëron një llogari pagese dhe kryen veprime me të, synon arritjen e objektivave të përcaktuar në strategjinë kombëtare për pagesat me vlerë të vogël.

Brenda vitit 2019, do të miratohet dhe do të hyjë në fuqi projektligji "Për shërbimet e pagesave në Republikën e Shqipërisë". Kuadri rregullativ në zbatim të këtij akti synohet të miratohet brenda vitit 2020.

Në projektet e mësipërme, Banka e Shqipërisë përfiton nga asistencë teknike e Bankës Botërore, e financuar nga Sekretariati Shtetëror Zvicëran për Çështjet Ekonomike (SECO).

- b) Nxitja e funksionimit normal të sistemit të pagesave, nëpërmjet rolit reformator dhe katalizator;

Banka e Shqipërisë synon krijimin e një tregu bashkëkohor dhe gjithëpërfshirës të pagesave me vlerë të vogël, të mbështetur nga infrastruktura të sigurt dhe

eficiente, si dhe nga një gamë e gjerë instrumentesh e shërbimesh të pagesave që përmbushin nevojat e përdoruesve të tyre, të aftë financiarisht, në të gjithë vendin.

Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim luan dhe Komiteti Kombëtar i Sistemit të Pagesave dhe Strategjia Kombëtare për Pagesat me Vlerë të Vogël. Banka e Shqipërisë do të vijojë punën për zbatimin e planit të veprimit të strategjisë dhe organizimin e takimeve e aktiviteteve të tjera të nevojshme në këtë drejtim.

- c) Nxitja e funksionimit normal të sistemit të pagesave, nëpërmjet krijimit dhe operimit të sistemeve të pagesave.

Banka e Shqipërisë synon të nxisë përdorimin e instrumenteve elektronike të pagesave, nëpërmjet zhvillimeve infrastrukturore, për të garantuar qarkullimin e sigurt, të shpejtë dhe me kosto të ulët, të parasë në ekonomi.

Brenda vitit 2019, do të hartohen termat e referencës për implementimin e shlyerjes së transfertave në euro të klientëve të bankave tregtare në territorin shqiptar. Implementimi i infrastrukturës përkatëse do të realizohet gjatë vitit 2020.

Gjatë 2019-ës, synohet të finalizohet hartimi i skemës së debitimit direkt ndërbankar.

Në periudhën 2019-2022, do të punohet për krijimin e platformës kombëtare për procesimin e pagesave elektronike SWITCH dhe *Instant Payments*. Kjo përfshin hartimin e planit të fizibilitetit, termat e referencës për funksionimin e skemës/infrastrukturës, implementimin e infrastrukturës së zgjedhur dhe zbatimin e projektit.

Në drejtim të zgjerimit të pjesëmarrjes në Sistemin e Klerimit të Pagesave me Vlerë të Vogël, do të punohet për identifikimin e zhvillimeve të nevojshme infrastrukturore dhe ndryshimeve rregullative për akomodimin e pjesëmarrjes së institucioneve financiare jobanka në këtë sistem, si dhe zbutjen e rreziqeve të mundshme. Këto do të realizohen brenda T2 2019.

#### 4.4 PROMOVIMI I STABILITETIT TË SISTEMIT FINANCIAR

Stabiliteti financiar është aftësia e sistemit financiar (institucioneve, tregjeve dhe infrastrukturës përkatëse) për të kryer me efikasitet funksionet e tij (duke përfshirë ndërmjetësimin financiar), në kushte normale dhe në situata ekonomike më të pafavorshme. Për të ruajtur stabilitetin financiar është e nevojshme të parandalohen rreziqet me rëndësi sistematike, si dhe të rritet rezistenca e sistemit financiar dhe e sektorit bankar ndaj tyre.

Trajtimi i rreziqeve sistemike në sistemin financiar është objekt i politikës makroprudenciale.

#### 4.4.1 POLITIKA MAKROPRUDENCIALE

Nisur nga funksionet e saj ligjore dhe në kushtet kur sektori bankar mbizotëron në sistemin financiar shqiptar, Banka e Shqipërisë luan një rol parësor në zbatimin e politikës makroprudenciale. Ky rol evidentohet në Strategjinë e Politikës Makroprudenciale.

Banka e Shqipërisë do të angazhohet në vlerësimin, monitorimin dhe identifikimin e veprimeve për trajtimin e rreziqeve të sistemit financiar, me fokus të veçantë në rrezikun sistematik dhe sektorin bankar. Aty ku është e nevojshme, mbështetur në standardet më të mira ndërkombëtare dhe në procedurat ekzistuese në vend, kjo veprimtari do të kryhet në bashkëpunim me autoritete të tjera publike.

Strategjia e Politikës Makroprudenciale përmban një numër objektivash të ndërmjetëm që korrespondojnë me rreziqet kryesore që ndiqen në vijimësi nga Banka e Shqipërisë. Objektivi final i politikës makroprudenciale është të ndihmojë në sigurimin e stabilitetit të të gjithë sistemit financiar, përmes parandalimit dhe zbutjes së rreziqeve sistemike dhe forcimit të rezistencës së sistemit financiar.

Objektivat e ndërmjetëm përfshijnë:

- i. zbutjen dhe parandalimin e rritjes së tepërt të kreditimit dhe të borxhmarrjes;
- ii. zbutjen dhe parandalimin e mospërputhjeve të mëdha në maturime dhe të mungesës së likuiditetit në treg;
- iii. kufizimin e përqendrimeve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të ekspozimeve;
- iv. kufizimin e sipërmarrjes së tepërt të rrezikut nga institucionet financiare me rëndësi sistemike;
- v. kontributin në ruajtjen e qëndrueshmërisë së infrastrukturës financiare.

Për këta objektiva, Banka e Shqipërisë do të punojë në drejtim të identifikimit të treguesve të paralajmërimit të rrezikut, si dhe të operacionalizimit të instrumenteve përkatëse makroprudenciale.

#### Objektivat kryesorë gjatë periudhës

- a) Finalizimi i listës së treguesve të paralajmërimit të hershëm për objektivat 1-4 të Politikës Makroprudenciale, deri në fund të vitit 2019;

Për këtë qëllim, Banka e Shqipërisë do të:

- krijojë, mirëmbajë në vijimësi dhe rivlerësojë rregullisht, bazën e nevojshme të të dhënave, duke kontribuar në ndërtimin e statistikave makroprudenciale;
  - përcaktojë nivelet kritike të treguesve që paralajmërojnë rreth zhvillimit të rreziqeve përkatëse e nevojës për të vepruar me instrumentin përkatës makroprudencial, si dhe do të rivlerësojë rregullisht përshtatshmërinë e këtyre niveleve;
  - ndërtojë analizën për vlerësimin e rregullt të ecurisë së treguesve, e cila do të informojë organet vendimmarrëse të institucionit rreth vlerësimeve dhe veprimeve të nevojshme makroprudenciale.
- b) Zbatimi i shtesave makroprudenciale të kapitalit për sektorin bankar, ku ndërthuren objektivat 1, 3 dhe 4 të politikës makroprudenciale, brenda vitit 2019;

Banka e Shqipërisë do të përgatisë metodologjitë përkatëse për zbatimin e shtesës kundërciklike të kapitalit dhe të shtesës së kapitalit për bankat me rëndësi sistematike, duke përcaktuar treguesit bazë për aktivizimin e këtyre instrumenteve makroprudenciale.

- c) Zhvillimi i instrumenteve makroprudenciale që lidhen me rreziqet sektoriale, duke përfshirë ata të huadhënies për zhvillimin ose blerjen e pasurive të paluajtshme, brenda vitit 2020;

Banka e Shqipërisë do të plotësojë kuadrin e procedurave për raportimin e të dhënave që mundësojnë llogaritjen dhe zbatimin e instrumenteve të tilla si vlera e huasë/vlera e kolateralit, vlera e (shërbimit të) huasë/të ardhurat.

- d) Pasurimi i procedurave të brendshme, për të dokumentuar të gjithë procesin e ciklit të politikës makroprudenciale, brenda vitit 2020;
- e) Plotësimi i metodologjive për ushtrimin e provës së rezistencës për qëllime makroprudenciale, brenda vitit 2021.

Në fokus është ndërtimi i modeleve që vlerësojnë mundësinë e përhapjes së rrezikut midis institucioneve financiare banka dhe jobanka. Për këtë qëllim, do të bashkëpunohet me institucionet financiare ndërkombëtare apo njësi të tjera të specializuara në dhënien e asistencës teknike profesionale.

Plotësimi i objektivave të mësipërm do të mundësojë përmirësimin e cilësisë së publikimeve ekzistuese, realizimin e vlerësimeve të reja dhe rritjen e gamës së publikimeve në kuadër të stabilitetit financiar. Ky proces do të rrisë kontributin e Bankës së Shqipërisë në identifikimin, parandalimin dhe vlerësimin e rreziqeve të stabilitetit financiar, në bashkëpunim me institucionet e tjera brenda dhe jashtë vendit.

Për realizimin e objektivave të mësipërm, Banka e Shqipërisë do të shfrytëzojë burimet ekzistuese njerëzore, financiare dhe teknike, duke përdorur sinergjitë që çlirohen nga bashkëpunimin midis departamenteve që kontribuojnë më drejtpërdrejtë në çështjet e stabilitetit financiar. Nëse do të rezultojë e nevojshme nga vlerësimet periodike të përmbushjes së objektivave, do të vepohet për rritjen e burimeve ekzistuese.

#### 4.4.2 LICENCIMI, RREGULLIMI DHE MBIKËQYRJA BANKARE

Banka e Shqipërisë synon zbatimin dhe zhvillimin e politikave dhe praktikave më të mira për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë bankare/financiare, me qëllim sigurimin e stabilitetit të sistemit bankar dhe reduktimin e rrezikut të humbjes për depozituesit.

Objektivat kryesorë të funksionit mbikëqyrës janë: ruajtja e besimit në sistemin bankar; mbrojtja e depozituesve; nxitja e disiplinës së tregut dhe të konkurrencës së ndershme; si dhe garantimi i një veprimtarie të shëndoshë të institucioneve bankare e financiare. Të gjitha këto kontribuojnë në forcimin e stabilitetit financiar në vend.

Përmes ushtrimit të mbikëqyrjes, Banka e Shqipërisë identifikon rreziqet ndaj të cilave ekspozohen bankat e subjektet e tjera të licencuara, si dhe vlerëson nëse strategjitë, strukturat organizative dhe politikat e tyre, së bashku me nivelet e kapitalit dhe likuiditetit, sigurojnë një administrim të kujdesshëm e të mjaftueshëm të këtyre rreziqeve.

##### Objektivat kryesorë gjatë periudhës

- a) Përafrimi i kuadrit rregullator e metodologjik me legjislacionin e Bashkimit Evropian, adoptimi i parimeve të Komitetit të Bazelit dhe adresimi i problematikave të vërejtura dhe sugjerimeve të paraqitura nga ana e subjekteve të mbikëqyrura;

Nismat kryesore ligjore kanë të bëjnë me përshtatjen në kuadrin rregullativ mbikëqyrës të kërkesave të Bazelit III, të projektligjit "Për shërbimet e pagesave në Republikën e Shqipërisë" dhe të ligjit "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë".

- b) Konsolidimi i mëtejshëm i mbikëqyrjes së bazuar në rrezik;

Konfigurimi i Procesit të Rishikimit dhe Vlerësimit Mbikëqyrës, që do të pasqyrohet nëpërmjet përditësimeve të nevojshme metodologjike dhe operacionale, synon të sigurojë rezervat e nevojshme të kapitalit nga bankat. Cilësia e administrimit të

bankave do t'i nënshtrohet kërkesave të përmirësuara mbikëqyrëse me përfundimin e rishikimit të metodologjisë së brendshme për vlerësimin e qeverisjes/drejtimin të tyre.

Një tjetër komponent i rëndësishëm i mbikëqyrjes mikroprudenciale janë analizat stres-test, përmes të cilave Banka e Shqipërisë u kërkon bankave të zhvillojnë analizat e tyre, si pjesë e procesit të vetëvlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit. Pritshmëritë mbikëqyrëse në lidhje me aspekte të ndryshme të këtyre analizave do të rishikohen, duke u finalizuar në një rregullore të posaçme, brenda vitit 2019.

c) Reduktimi i mëtejshëm i stokut të kredive me probleme;

Gjatë periudhës afatmesme në vijim, ndërhyrja e Bankës së Shqipërisë do të konsistojë në drejtim të: zbatimit të plotë të masave të parashikuara në Planin Kombëtar për Kreditë e Këqija; monitorimit të kujdesshëm të praktikave të bankave për krijimin e fondeve rezervë për humbjet nga kreditë; zhvillimit të tregut për shitjen e kredive me probleme; nxitjes së bankave drejt zbatimit të planeve të rimëkëmbjes së kredimarrësve të mëdhenj dhe orientimit të kredisë së re në sektorë të shëndetshëm të ekonomisë.

d) Ndjekja e vazhdueshme e zhvillimeve teknologjike dhe inovacioneve në sistemin financiar dhe në sistemet e pagesave.

Përmbushja e objektivave të mësipërm do të realizohet përmes bashkëpunimit të qëndrueshëm dhe shkëmbimit të vazhdueshëm të informacionit me interes të përbashkët me autoritetet e huaja mbikëqyrëse dhe autoritetet vendase përgjegjëse për mbikëqyrjen e veprimtarisë së subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë.

Për sa më sipër, do të vlerësohet përshtatshmëria e kapaciteteve teknike dhe njerëzore të institucionit. Nëse do të jetë e nevojshme, do të konsiderohet dhe rritja në numër e tyre.

Progresi i realizuar në përmbushjen e objektivave të mësipërm do të paraqitet në raportet vjetore të mbikëqyrjes.

#### **4.4.3 NDËRHyrJA E JASHTËZAKONSHME NË BANKA**

Në cilësinë e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, Banka e Shqipërisë ushtron kompetencat e saj për të siguruar një ndërhyrje të organizuar në bankat me paafësi paguese, duke minimizuar ndikimin e saj në ekonominë reale, financat publike dhe stabilitetin financiar.

Objektivat e ndërhyrjes së jashtëzakonshme janë:

- të sigurojë vazhdimësinë e funksioneve kritike të bankës;
- të shmangë çdo pasojë të rëndë negative për stabilitetin e sistemit financiar, duke parandaluar përhapjen e rreziqeve, përfshirë edhe infrastrukturën e tregut, dhe duke ruajtur disiplinën e tregut;
- të mbrojë fondet publike, duke minimizuar mbështetjen financiare publike të jashtëzakonshme;
- të mbrojë depozituesit e siguruar nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave;
- të mbrojë fondet dhe aktivet e tjera të klientëve.

Brenda vitit 2022, do të hartohen planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme për çdo bankë, mbi bazën e informacionit që mblidhet nga vetë bankat.

Banka e Shqipërisë është në procesin e identifikimit të funksioneve me rëndësi kritike për çdo bankë, bazuar në informacionin e dërguar prej tyre, përmes planeve të rimëkëmbjes dhe vlerësimeve të brendshme. Funksionet me rëndësi kritike të evidentuara dhe mënyra e ruajtjes së tyre do të përshihen në planet individuale të ndërhyrjes për çdo bankë.

### Objektivat kryesorë gjatë periudhës

- a) Analizimi i formularëve të plotësuar nga bankat, lidhur me informacionin e nevojshëm për hartimin e planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme;

Në shtator 2018, bankat kanë raportuar, për herë të parë, informacionin e nevojshëm për hartimin e planeve. Ky informacion lidhet me qeverisjen/drejtimin dhe administrimin e bankës, veprimtaritë kryesore, strukturën e pasiveve, kolaterale të vendosura, zërat jashtë bilancit, sistemet e përdorura për kryerjen e pagesave, klerimit dhe shlyerjes, sistemet e informacionit, ndërlidhjet dhe ndërvarësitë financiare e të tjera, si dhe marrëveshjet kontraktuale që mund të ndikojnë apo të ndikohen nga veprimet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Gjatë vitit 2019, do të analizohen formularët e plotësuar, paralelisht me hartimin e planeve për çdo bankë.

- b) Hartimi i rregullores "Për kërkesat për instrumente të kapitalit dhe detyrimet e pranuar";

Kjo rregullore do të përcaktojë mënyrën e vlerësimit të kërkesës minimale për kapital dhe detyrime të pranuar, si burimi kryesor i financimit të bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme, në rast të zbatimit të instrumentit të rikapitalizimit nga brenda. Rregullorja do të hartohet brenda vitit 2019. Niveli individual i



kërkesës për këtë instrument, për secilën bankë, do të përfshihet në planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, gjatë vitit 2020.

- c) Zhvillimi cilësor i personelit dhe kapaciteteve teknike, si dhe përmirësimi i strukturës organizative.

Në drejtim të zhvillimit cilësor të personelit, Banka e Shqipërisë do të angazhohet në nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me autoritete homologe të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, në nivel evropian. Brenda vitit 2019, do të nënshkruhet marrëveshja e bashkëpunimit me Bordin e Përbashkët të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, çka do të ofrojë një mbështetje të fortë për zhvillimin cilësor të burimeve njerëzore.

Struktura organizative e njësisë përgjegjëse për ndërhyrjen e jashtëzakonshme në Bankën e Shqipërisë mbështetet mbi parimin e specializimit të specialistëve të hartimit të planeve të ndërhyrjes, sipas portofolit të grupeve të bankave individuale në raportin: një bankë sistemike dhe një grup bankash josistemike për çdo specialist. Ky raport mundëson hartimin cilësor të planeve të ndërhyrjes dhe mbështetjen e tyre përmes heqjes së pengesave për çdo bankë, në përputhje me ligjin.

## 4.5 MIRËQEVERISJA E INSTITUCIONIT

Banka e Shqipërisë synon forcimin e mëtejshëm të mirëqeverisjes, përmes rritjes së pavarësisë institucionale, transparencës dhe llogaridhënies.

### 4.5.1 PAVARËSIA

Rritja e pavarësisë së institucionit në përmbushjen e misionit dhe objektivave ligjorë është në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga procesi i përafrimit gradual me legjisllacionin e Bashkimit Evropian.

Banka e Shqipërisë synon harmonizimin e plotë të ligjit të vet organik me Statutin e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore.

### 4.5.2 LLOGARIDHËNIA

Banka e Shqipërisë synon rritjen e llogaridhënies përpara Kuvendit dhe publikut të gjerë, për përmbushjen e detyrave ligjore, objektivit kryesor dhe objektivave strategjike.

## Objektivat kryesorë gjatë periudhës

- a) Përgatitja e pasqyrave financiare, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF);

Banka e Shqipërisë synon hartimin dhe publikimin e pasqyrave financiare që paraqesin në mënyrë të drejtë situatën financiare të institucionit, sipas SNRF-ve. Kjo kërkon edhe zbatimin e politikave kontabël të përshtatshme për institucionin. Gjatë periudhës afatmesme në vijim, do të reflektohen ndryshimet në SNRF-të ekzistuese dhe aplikimi i standardeve të reja në politikat kontabël dhe implementimin e tyre.

Realizimi i këtij objekti kërkon përditësimin e personelit me risitë dhe publikimet më të fundit rreth standardeve të kontabilitetit dhe interpretimit të tyre nga ana e Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

- b) Menaxhimi efektiv financiar, forcimi i kapaciteteve institucionale dhe përdorimi me eficiencë i burimeve, bazuar në një proces të mirëdizenjuar dhe mirëqeverisur të planifikimit strategjik e buxhetimit;

Banka e Shqipërisë synon një reflektim sa më të saktë dhe real të parashikimeve buxhetore, në përputhje me Strategjinë Afatmesme.

Në kuadër të automatizimit të procesit të hartimit të buxhetit, brenda vitit 2019, do të vlerësohen nevojat dhe alternativat për përshtatjen dhe përdorimin e një programi aktual, apo krijimin e një aplikacioni të ri, me burime të brendshme ose të jashtme.

Në varësi të zgjidhjes do të variojnë edhe burimet financiare për blerjen/zhvillimin e një moduli për procesin e planifikimit të buxhetit në Bankën e Shqipërisë. Kjo përfshin edhe kostot e trajnimit të personelit, apo asistencën e mundshme për marrjen e përvojës nga banka të tjera qendrore.

- c) Përmirësimi i ndërlidhjes së proceseve të planifikimit strategjik dhe buxhetimit.

Banka e Shqipërisë synon përmirësimin e procesit të zbërthimit të objektivave të kësaj strategjie në plane financiare, për të mbështetur hartimin dhe miratimin e buxhetit vjetor dhe atij afatmesëm.

Gjatë periudhës afatmesme në vijim, do të punohet për hartimin e udhëzuesit për menaxhimin financiar dhe buxhetimin në një linjë me strategjinë, si dhe për ndërgjegjësimin dhe udhëzimin e njësisve organizative për përcaktimin e objektivave të matshëm dhe hartimin e buxheteve në përputhje me këta objektiva.

Për këtë qëllim do të shfrytëzohen praktikat më të mira dhe modelet e ofruara nga misionet e FMN-së dhe, nëse do jetë e nevojshme, do të kërkohet konsulencë dhe/ose personel i dedikuar për bashkërendimin e planifikimit strategjik me atë buxhetor.

#### 4.5.3 TRANSPARENCA DHE KOMUNIKIMI ME PUBLIKUN

##### Objektivat kryesorë në fushën e transparencës dhe komunikimit me publikun

###### a) Rritja e transparencës;

Rritja e transparencës nënkupton zgjerimin e informacionit dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kanaleve të komunikimit të Bankës së Shqipërisë me publikun dhe grupet e ndryshme të interesit, në funksion të rritjes së besueshmërisë së institucionit dhe efikasitetit të politikës monetare. Kjo qasje do të bashkërendohet efektivisht brenda institucionit për të qenë pjesë e politikës së përgjithshme të komunikimit.

###### b) Komunikimi me publikun;

Komunikimi i hapur dhe transparent me publikun ndihmon në rritjen e efektivitetit të politikave të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, duke kontribuar në rritjen e besueshmërisë së institucionit. Në këtë kuadër, komunikimi me publikun përbën një çështje me rëndësi strategjike për Bankën e Shqipërisë, me qëllim që opinioni publik të informohet dhe të kuptojë drejt vendimmarrjen dhe politikat e zbatuara prej saj.

###### i. Hedhja në qarkullim e serisë së re të kartëmonedhave

Banka e Shqipërisë do të prezantojë për publikun serinë e re të kartëmonedhave në vitin 2019 dhe do të hedhë në qarkullim prerje të kësaj serie gjatë periudhës 2019 - 2021.

Prezantimi dhe hedhja në qarkullim e kësaj serie përbën një ngjarje shumë të rëndësishme, një moment të veçantë, jo vetëm për Bankën e Shqipërisë, por për gjithë shtetin shqiptar. Pas më shumë se 20 vitesh, dizenjoja e kartëmonedhave të qarkullimit vjen e rifreskuar dhe elementet përkatëse të sigurisë janë përmirësuar, duke i dhënë kartëmonedhës shqiptare pamjen e një kartëmonedhe moderne, në të njëjtën kohë rezistente, me cilësi, integritet dhe besueshmëri të lartë, të krahasueshme me ato të vendeve më të përparuara.

Për vetë natyrën e përdorimit të saj si mjet pagese, paraja përbën një element kombëtar që prek jetën e të gjithë qytetarëve, pa dallim moshe, vendbanimi

apo statusi ekonomik. Prandaj, Banka e Shqipërisë synon të informojë qytetarët shqiptarë mbi pamjen e re dhe elementët e sigurisë për serinë e re të kartëmonedhave që do të hidhet në qarkullim.

ii. Heqja e terminologjisë “lek i ri – lek i vjetër”

Prej më shumë se 50 vitesh, qytetarët shqiptarë përdorin në përditshmërinë e tyre financiare termin “lek i ri – lek i vjetër”, referuar një vendimi të shtetit shqiptar të vitit 1965, i cili vendoste raportin e këmbimit të lekut, në vlerën 10 lekë të vitit 1947 dhe 1957, të barasvlefshëm me 1 lek të vitit 1964. Kjo mendësi është transmetuar nga njëri brez në tjetrin për dekada me radhë, deri sot, duke sjellë shpeshherë ngatërresa në llogaritje e pagesa, ndryshime çmimesh me një 0 për produkte e shërbime të njëjta që ofrohen në treg, konfuzion për turistët e huaj mbi çmimet në Shqipëri etj.

Pikërisht për të shmangur këtë konfuzion, Banka e Shqipërisë do të ndërmarrë një fushatë kombëtare disavjeçare për ndërgjegjësimin e publikut se sot ka vetëm lekë, pra vlera nominale e shkruar mbi monedhën kombëtare dhe jo më lek i ri apo lek i vjetër.

c) Muzeu i Bankës së Shqipërisë dhe edukimi financiar

Muzeu i Bankës së Shqipërisë është një instrument i rëndësishëm për komunikimin e institucionit me publikun. Gjatë tre viteve në vijim, synohet që Muzeu të luajë një rol të rëndësishëm për rritjen e kulturës financiare në vend, duke tërhequr vëmendjen e publikut të gjerë dhe në veçanti të nxënësve të shkollave dhe studentëve.

Prezantimi i përmbajtjes së Muzeut, sipas grupeve të interesit dhe në funksion të objektivave të edukimit financiar, synon rritjen e njohurive dhe ndërgjegjësimin të publikut mbi:

- Bankën e Shqipërisë dhe sistemin financiar;
- monedhën shqiptare dhe politikën për miradministrimin e saj.

### Objektivat kryesorë gjatë periudhës

a) Plotësimi i përmbajtjes në gjithë hapësirat e Muzeut;

Në bashkëpunim me institucionet dhe bashkëpunëtorët shkencorë, do të punohet për përgatitjen e historikut të institucionit dhe të sistemit bankar shqiptar, në kuadër të 100-vjetorit të fillimit të aktivitetit të Bankës Kombëtare të Shqipërisë. Lidhur me këtë objektiv synohet:

- kërkimi, mbledhja dhe hulumtimi i materialeve historike e dokumenteve arkivore në fushën e çarkullimit monetar, sistemeve të pagesave, zhvillimeve institucionale të tregut e politikës së administrimit monetar e financiar;
- aktivizimi i bashkëpunëtorëve shkencorë për hartimin dhe publikimin e materialeve shkencore, në funksion të përmbajtjes së Muzeut dhe prezantimi i tyre për publikun.

b) Shtimi i objekteve dhe koleksioneve numizmatike;

Ky objektivi do të realizohet përmes shtypjes së monedhave të reja për qëllime numizmatike, blerjes së koleksioneve dhe objekteve me rëndësi historike, si dhe bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave dhe institucione të fushës për huazimin e objekteve me rëndësi historike.

c) Pasurimi i komunikimit përmes aktiviteteve në funksion të edukimit.

Zhvillimi i aktiviteteve të edukimit financiar synojnë rritjen e kulturës dhe përfshirjes financiare në shoqërinë shqiptare. Për këtë, do të punohet për edukimin financiar të qytetarëve mbi përdorimin e instrumenteve dhe teknologjive financiare, përmes ofrimit të informacionit, sipas grup-moshave, me qëllim rritjen e përfshirjes financiare të tyre. Kjo do të realizohet nëpërmjet:

- leksioneve të organizuara nga personeli i Bankës së Shqipërisë ose lektorë të ftuar në funksion të tematikave të të interesuarve;
- orëve edukative jashtëkurrikulare ofruar nga personeli i Muzeut me shkollat 9-vjeçare, për edukimin financiar të fëmijëve të moshave 6-12 vjeç.

Nga ana tjetër, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare, Banka e Shqipërisë synon të zhvillojë projekte të vazhdueshme për vlerësimin e kulturës financiare në shoqërinë shqiptare.

## 4.6 SISTEMI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Banka e Shqipërisë funksionon në përputhje me një set rregullash dhe kontrollesh që rregullojnë strukturën organizative dhe operacionale, duke përfshirë proceset e raportimit dhe funksionet për auditimin e brendshëm, administrimin e rrezikut operacional dhe vijueshmërinë e veprimtarisë.

Sistemi i Kontrollit të Brendshëm kontribuon në përmbushjen e objektivave, duke siguruar efektivitetin e institucionit, respektimin e politikave të drejtimit, ruajtjen e mjeteve, parandalimin dhe zbulimin e mashtrimeve dhe gabimeve, saktësinë dhe plotësinë e regjistrimeve kontabël, si dhe përgatitjen në kohë të informacionit të besueshëm financiar.

#### 4.6.1 AUDITIMI I BRENDSHËM

Synimi i auditimit të brendshëm është të shërbejë si një këshillues i besueshëm i administratorëve dhe i Komitetit të Auditimit. Kjo përfshin krijimin e eksperiencës së mjaftueshme për kuptimin e nevojave të drejtimit, adresimin e duhur të rreziqeve strategjike dhe ndërgjegjësimin mbi rreziqet e reja e masat parandaluese për t'u mbrojtur nga to.

##### Objektivat kryesorë gjatë periudhës

Objektivat kryesorë për periudhën 2019-2021 fokusohen në sigurimin e pajtueshmërisë me standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, për sa i përket:

- a) zbatimit të planit të masave për implementimin e rekomandimeve të vlerësimit të jashtëm dhe të brendshëm të cilësisë së funksionit të auditimit të brendshëm, me qëllim pajtueshmërinë e plotë me standardet ndërkombëtare të fushës. Kjo përfshin edhe vetëvlerësimin dhe përgatitjen për vlerësimin e jashtëm të radhës;
- b) rritjes së pavarësisë dhe cilësisë së auditimit të brendshëm, nëpërmjet forcimit të linjave të raportimit me administratorët dhe Komitetin e Auditimit;
- c) ndërgjegjësimin të personelit të institucionit mbi funksionimin dhe ndarjen e qartë të Linjës I të mbrojtjes (funksionet), Linjës II (administrimi i rrezikut dhe përputhshmëria) dhe Linjës III (auditimi i brendshëm), si dhe bashkërendimi midis Linjës II dhe III.

Gjithashtu, do të punohet në drejtim të forcimit të rolit të Komitetit të Auditimit për sa i përket: (i) integritetit të procesit të raportimit financiar; (ii) mjaftueshmërisë së sistemit të kontrollit të brendshëm; (iii) performancës së funksioneve të auditimit të brendshëm e të jashtëm dhe administrimit të rrezikut operacional; si dhe (iv) përputhshmërisë me kuadrin ligjor dhe rregullator.

Kjo do të mundësojë një fokus më të thelluar dhe një efektivitet më të lartë të Këshillit Mbikëqyrës në trajtimin e çështjeve të lidhura me transparencën dhe llogaridhënien e Bankës së Shqipërisë.

#### 4.6.2 ADMINISTRIMI I RREZIKUT OPERACIONAL

Banka e Shqipërisë synon shndërrimin e kuadrit të Administrimit të Rrezikut Operacional (ARO) në një instrument eficient e cilësor të parandalimit dhe minimizimit të rrezikut operacional ndaj të cilit ekspozohet.

Gjatë periudhës afatmesme në vijim, ARO do të informojë dhe mbështesë rregullisht vendimmarrjen mbi rreziqet që mund të pengojnë arritjen e objektivave, apo të kenë ndikime negative financiare dhe/ose reputacionale për institucionin.

Objektivat kryesorë përfshijnë rritjen dhe konsolidimin e nivelit të maturitetit të kuadrit për administrimin e rrezikut operacional, si një instrument bazë për vlerësimin nga International *Operational Risk Working Group* dhe vetëvlerësimin e aftësisë së Bankës së Shqipërisë për miradministrimin e rrezikut operacional. Masat për arritjen e objektivave të mësipërm lidhen me themelet e modelit të vlerësimit të nivelit të maturimit të ARO-s:

- a) rritja e kulturës së rrezikut, duke ndërgjegjësuar mbi vlerat e administrimit të rrezikut;
- b) mirëqeverisja duke integruar ARO-n me funksionet e njëjësive;
- c) përmirësimi i raportimit mbi rrezikun nga njësitë në plotësi, cilësi dhe kohë, si dhe raportimi i efektivitetit të planeve të veprimit në reduktimin e rrezikut;
- d) përmirësimi i Procesit të Menaxhimit të Rrezikut Operacional, nëpërmjet një sistemi gjithëpërfshirës, në nivel institucioni, të Treguesve Kyç të Rreziqeve;
- e) marrja në konsideratë gjatë planifikimit strategjik e Rezultateve të Menaxhimit të Rrezikut;
- f) ndërgjegjësimi, mbështetja dhe nxitja e përdorimit të sinjalizimit për parandalimin dhe zbulimin e sjelljeve korruptive apo mashtrimeve.

#### 4.6.3 VIJUESHMËRIA E VEPRIMTARISË

Banka e Shqipërisë synon sigurimin e vijueshmërisë së aktiviteteve kritike dhe rikuperimin e tyre në një kohë të arsyeshme e me humbje minimale.

Objekivi kryesor për periudhën afatmesme në vijim është hartimi dhe implementimi i Programit të Menaxhimit të Vijueshmërisë së Veprimtarisë (MVV). Ky program ka për qëllim krijimin e aftësisë strategjike e taktike për të planifikuar dhe për t'iu përgjigjur në kohë ngjarjeve, krizave operacionale dhe ndërprerjeve të veprimtarisë, pa cenuar vijimin e aktiviteteve.

Në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira të fushës, masat e planifikuara për arritjen e objektivit përfshijnë realizimin e Analizës së Impaktit në Veprimtari, përmes identifikimit dhe përcaktimit të:

- aktiviteteve kritike sipas ndikimit të ndërprerjes së tyre;
- ndërvarësive midis aktiviteteve kritike;
- treguesve të vijueshmërisë për aktivitetet kritike;
- infrastrukturës mbështetëse të aktiviteteve kritike dhe burimeve të nevojshme për sigurimin e vijueshmërisë dhe/ose rimëkëmbjen e tyre në kohë.

Përpara miratimit, programi i MWV-së do të diskutohet me palët e interesit.

Gjithashtu, do të punohet në drejtim të hartimit, miratimit dhe implementimit të:

- strategjive të MWV-së për rimëkëmbjen e proceseve dhe burimeve;
- planeve të vijueshmërisë së veprimtarisë dhe Planeve të Reagimit Emergjent.

## 4.7 KAPITALI NJERËZOR, FIZIK DHE FINANCIAR

Në përputhje me parimin e pavarësisë, Banka e Shqipërisë synon të ketë në dispozicion burime të mjaftueshme njerëzore, fizike dhe financiare, për të përmbushur mandatin e vet ligjor.

### 4.7.1 POLITIKAT MBI MARRËDHËNIET E PUNËSIMIT, KUALIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E KARRIERËS

Në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të shërbimit dhe cilësisë së punës, politikat e burimeve njerëzore në Bankën e Shqipërisë mbështesin vazhdimisht njësitë organizative për arritjen e objektivave të tyre.

Banka e Shqipërisë është e përkushtuar në zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve njerëzore, për garantimin e qëndrueshmërisë së shërbimeve dhe adresimin e sfidave të reja. Ky proces realizohet përmes bashkërendimit dhe komunikimit ndërmjet njësisë organizative, përshtatjen e tyre me detyrat e reja që burojnë nga kuadri rregullativ dhe nga standardet e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore.

#### Objektivat kryesorë gjatë periudhës

- a) Identifikimi i kapaciteteve njerëzore profesionale, përdorimi i tyre në funksion të zhvillimit të personelit sipas fushave të interesit, dhe përvetësimi i praktikave më të mira të administrimit të burimeve njerëzore;
- b) Përmirësimi dhe përdorimi efektiv i kapaciteteve teknologjike, me qëllim administrimin sa më të mirë të kohës së punës dhe identifikimin e proceseve që kanë nevojë të përmirësohen;
- c) Promovimi i një kulture që mbështetet në bashkëpunimin midis departamenteve dhe në shkëmbimin e përvojës profesionale;
- d) Identifikimi dhe ofrimi i trajnimeve të reja e cilësore, brenda dhe jashtë vendit, që rrisin njohuritë e personelit për proceset aktuale dhe krijojnë baza për përmirësimin e punës dhe futjen e proceseve/metodave të reja.



#### 4.7.2 EFEKTIVITETI NË PËRDORIMIN E FONDEVE

Banka e Shqipërisë synon të rrisë efektivitetin në procedurat e prokurimit, të sigurojë mirëpërdorimin e fondeve dhe të ulë shpenzimet e veta procedurale.

##### Objektivat kryesorë gjatë periudhës

a) Rikonstruksioni i godinës nr. 2 të Bankës së Shqipërisë;

Ky objektivi do të realizohet përmes:

- lidhjes së kontratës me sipërmarrësin me kriteret që diktojnë respektimin e afateve;
- lidhjes së kontratës me mbikëqyrësin e punimeve për të garantuar cilësi dhe respektim afatesh;
- ndjekjes së punimeve nga personeli teknik për të garantuar respektimin e grafikut dhe dorëzimin e projektit sipas afatit të përcaktuar në kontratë.

b) Ndërtimi i një objekti të ri për nevojat e Emisionit;

Ky objektivi do të realizohet përmes:

- organizimit të konkursit për përzgjedhjen e projektuesit;
- realizimit të procedurave të prokurimit për projektin dhe sipërmarrësin;
- pajisjes me lejet përkatëse;
- ndjekjes së punimeve nga personeli teknik për të garantuar respektimin e afateve kohore të parashikuara.

c) Realizimi i procedurave të prokurimit brenda afateve dhe në mënyrë cilësore.

#### 4.7.3 TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT

Teknologjia e informacionit është pjesë integrale e përmbushjes së objektivave afatmesëm.

##### Objektivat kryesorë gjatë periudhës

Gjatë periudhës 2019-2021, do të investohet në teknologji të reja për përmbushjen e objektivave në vijim.

a) Përmirësimi i infrastrukturës;

Banka e Shqipërisë synon zgjerimin dhe përmirësimin e infrastrukturës së rrjetit, në mënyrë të vazhdueshme, duke ndjekur zhvillimet e teknologjisë dhe praktikat më të mira botërore. Një peshë të rëndësishme zë procesi i virtualizimit të pajisjeve qendrore për një administrim më të mirë, duke optimizuar shërbimet dhe kostot e lidhura me to. Në fokus janë dhe teknologjitë e reja për mbrojtjen e mjedisit dhe me eficiencë në energji.

b) Automatizimi i proceseve;

Mbështetja e veprimtarisë përmes futjes së inovacioneve për automatizimin e proceseve mbetet një objektivi për rritjen e eficiencës dhe produktivitetit të institucionit. Në fokus është automatizimi i bilancit të pagesave, i cili do të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë, performancës dhe sigurisë së këtij procesi.

c) Përmirësimi i sistemeve dhe rritja e qëndrueshmërisë së tyre;

Mbështetja e veprimtarisë me zgjidhje të integruara, zhvillimi i teknologjisë dhe zgjerimi i funksioneve, do të shoqërohen me përmirësim të sistemeve mbështetëse. Në fokus kryesor është përmirësimi i sistemit të Regjistrimit të Kredive.

d) Shtimi dhe përmirësimi i shërbimeve elektronike;

Përveç përmirësimeve të vazhdueshme në funksion të zhvillimeve të teknologjisë, do të vazhdojë zgjerimi i përdorimit të shërbimeve që Banka e Shqipërisë u ofron të tretëve.

e) Siguria në teknologjinë e informacionit.

Mbështetja në standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira, ndjekja e zhvillimeve të teknologjisë në fushën e sigurisë dhe implementimi i tyre në infrastrukturën informatike, mbeten objektiva kyçë.

Në veçanti, programi i sigurisë së shërbimit SWIFT-CSP (*Customer Security Program*) ndërthur përmirësime rregulative, procedurale e teknike, me një monitorim rigoroz e të vazhdueshëm, të shoqëruar me analizën e rrezikut në teknologjinë e informacionit. Ky program mund të shërbejë edhe si një indikator për vendimmarrje në bazë të rrezikut.

Për realizimin e objektivave të mësipërm, Banka e Shqipërisë do të shfrytëzojë edhe ndihmën apo konsulencën e institucioneve financiare ndërkombëtare.



